**VENDIM**
**Nr.401, datë 11.7.2007**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE RREGULLATIVE TË EUROKONTROLLIT PËR SIGURINË NË AVIACIONIN CIVIL SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, si dhe të nenit 2.1, pika IV, e protokollit 1, të ligjit nr.9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, në Kosovë "Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit europian"", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kërkesave rregullative të Eurokontrollit, për sigurinë në Aviacionin Civil Shqiptar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**